

URDHRI FRANÇESKAN, MODEL KULTUROR, LETRAR DHE ARSIMOR

Alma DEMA¹

¹Departamenti i Letërsisë
@Fakulteti i Edukimit
almadema@uamd.edu.al

Abstrakt

Punimi *Urdhri françeskan, model kulturor, letrar dhe arsimor*, kërkon të nxjerrë në pah, kontributin e veçantë të këtij urdhri në përpunimin, lëvrimin dhe evidentimin e tipareve dhe karakteristikave autoktone shqiptare. Kjo mënyrë të të vështruar mbron idenë se pavarësisht se niveli i studimit antropologjik si dije akademike, nuk ishte në të njëjtën linjë me atë botërore, lënda e parë, ka ekzistuar dhe është nxjerrë në pah nga figurat aktive historike, politike, kulturore, letrare, gjuhësore a artistike. Ndër ta ishin edhe etërit françeskanë, praktikantë të urdhrin me të njëjtin emër, të cilët çështjen e Shqipërisë, marrëdhënia e saj si traditë, zakon, mendësi i ka shërbyer për të njohur më mirë vetveten, por edhe për t'ia prezantuar botës mbarë.

Si i tillë, punimi mbështetet mbi punën, gjykimin dhe përpjekjet për kodifikim të vlerave kulturore, letrare e arsimore ashtu si edhe etnologjike e antropologjike të: Fishtës, Konicës, Palajt, Kurtit, Pllumit, Harapit etj.

Metoda përshkruese, hulumtuese, me fokus të ngushtë dhe etnografike, na ka dhënë dorë të lirë për të konceptuar lëndën bazë dhe për të hedhur piketa për konfrontime dhe krahasime të mëtejshme në një areal më të gjerë ballkanik e evropian.

Etërit françeskanë për t'ia arritur qëllimit të tyre, i cili nisej nga shpirti i tyre i sakrificës, ngrehën një infrastrukturë profesionale e cila niste me përdorimin e gjuhës shqipe, botimin e teksteve skolasitike dhe jo vetëm, ambienteve funksionale, punë e përkushtim e shtrirë thuajse në çdo cep të Shqipërisë Veriore.

Fjalët kyçe: *franceskanë, model kulturor, trashëgimi kulturore, gjuha shqipe.*

Abstract in English

The paper *The Franciscan Order, a cultural, literary and educational model*, wants to highlight the special contribution of this order in the processing, cultivation and evidence of Albanian autochthonous features and characteristics. This way of looking at it defends the idea that despite the fact that the level of anthropological study as academic knowledge was not on the same line as that of the world, the raw material existed and was highlighted by active historical, political, cultural, literary figures, linguistic or artistic. Among them they were the Franciscan fathers, practitioners of the order with the same name, who served the issue of Albania, its relationship as a tradition, custom, mentality to better known themselves, but also to present it to the whole world.

As such, the paper relies on the work, judgment and efforts to codify the cultural, literary and educational as well as ethnological and anthropological values of: Fishta, Konica, Palaj, Kurti, Pllumi, Harapi, etc.

The descriptive, exploratory, narrowly focused and ethnographic method gave us free "rein" to conceptualize the basic subject and to lay milestones for further confrontations and comparisons in a wider Balkan and European area.

The Franciscan fathers to achieve their goal, which started from their spirit of sacrifice, built a professional infrastructure which started with the use of the Albanian language, the publication of scholastic texts and not only, functional premises, extensive work and dedication almost in every corner of Northern Albania.

Key words: *Franciscans, cultural model, cultural heritage, Albanian language.*

1. Urdhri françeskan si model kulturor, letrar dhe arsimor

Etërit françeskanë, si analogji nisen nga urdhri katolik françeskan, i cili mbahet me vetitë universale të përkores e të shërbimit. Është urdhër i njerëzve të përvuajtur e të besës. Induktivisht është urdhër fetar që i shërbente (*shërben*) urdhrin françeskan të themeluar nga San Françesko D' Asizi në Itali.

Françeskanët shqiptarë, përveçse i shërbyen urdhrin të tyre, i shërbyen me përvujtni edhe besës e jetës shqiptare. Ky është konsideruar një element shumë domethënës, si një lloj lejkalimi për të qenë të pranishëm, për të parë, për të vrojtuar, regjistruar e deri – deri pjesëmarrë në jetën e tyre të përditshme, të ndërtuar mbi rite, besëtytni, besime, tabu, gjykime e ide sa unike aq edhe universale.

Ndaj, përpos që përmbushi detyrën e besës, Urdhri françeskan, ndër shqiptarë, u rrit në model kulturor, letrar e arsimor, sepse autorët françeskanë:

- a) gjurmuan jetën e trashëgiminë shqiptare,
- b) zbuluan vetitë etnike tejkohore,
- c) mblodhën, studiuan e botuan trashëgiminë gojore,
- d) përkthyen e përshtaten në gjuhën shqipe vepra e kryevepra.

Françeskanët, krijuan, lëvruan dhe drejtuan letërsinë e kulturën shqiptare në shtigje ose të prekura kithtas ose të paprekura më parë, duke treguar profesionalizëm skollistik, atdhedashuri, përkujdesje deri në vetëmohim.

Ky është gjykimi i Karl Gurakuqit,⁹¹ gjykim i cili duket se përkon edhe me qasjen e studiuesit Adem Jakllari, për të cilin fundi i shekullit të XIX, *e gjet popullin shqiptar gati krejt të mpimë; vetëm vepra e disa atdhetarëve të pakët e zgjoi nga gjumi, e një pjesë shumë të rëndësishme në ket zgjim kombëtar [e ndër të tjerë] e ka sigurisht puna e ndritur e prodhimtare e At Gjergjit, si kryefrançeskan.*

Paralelisht me të gjithë elementet e tjerë antropologjikë të truallit të tij amë, ai dhe të gjithë etërit françeskanë ruajtën të paprekur konceptin dhe papërsëritshmërinë e racës ilire, arbnoe, shqipe, si një ati, biri e shpirti të shenjë në një.

Vetë Fishta në Konferencën e Paqes i konsideronte shqiptarët të vjetër sa fosilet, sa stalaktitet e shpellave jehuese të maleve të veta vigane, dhe i lindur të thuash prej vetë bucave të Shqipnisë, *ai asht sot zot autokton i pakundërshtueshëm i tokave të veta*. Vazhdon më tej në mënyrë më imponuese me pyetjet: *Thomëni, kush para shqiptarit i ngau qetë sinoreve të Ballkanit? Cili popull në Ballkan ka ndjesin ma të thellë për lirinë e vet sesa populli shqiptar?* (Shiroka, T. 2009;7)

Fishta, ashtu si pothuajse të gjithë françeskanët, përshkroi botën shqiptare të kohës së vet, realisht ashtu si mund ta përshkruante një malësor (malsuer), prodhim genuin e papeçatun i asaj bote. Edhe trajtat shprehëse të artit i nxori e i mori nga goja e malësorit, kështu që mund të thuhet se vepra e Fishtës është përpjekja më vigane që shqiptari bëri deri më tani për t'ia zbuluar vetvetes botën e vet.

Ai na e përshkruan shqiptarin duke ia nxjerrë lakuriq ndjesitë si të mira ashtu edhe të dobëta, domethëne vë në dukje atë shpirt ta tallazitur ku luftojnë fuqi centripetale dhe centrifugale. (Pllumi, Z. 2009; 16-17)

⁹¹ Fjalë e Luigj Gurakuqit në “Kuvendin Kombtar” lidhë me çështjen e Kosovës, shkëputur nga Bisedimet e Këshillit kombtar, Viti I, Nr. 12, 1921, fq. 178 – 179.

Gjergj Fishta, At⁹² dinte pse krijonte, çka krijonte, çka duhej të krijonte dhe si ta krijonte. (Berisha, A. 2006;9) Ai duke u bërë filozof i veprës së tij, bëhet edhe filolog i saj edhe historian dhe psikolog i saj. (Fishta, Gj.2000;16)

Madhnija e Fishtës, si interpret i pashoq i shpirtit të racës, e ka burimin në natyrën e tij shqiptare, me virtyte e vese që përmban ajo në vetvete. At Zefi, vazhdon më tej me këtë deklaratë: "Poeti ynë kombëtar qe fetar, por jo konfesional. Ndjesitë tepër të ndezura atdhedashurore ia prenë mundësinë e karrierës kishtarë. Jo pse eprorët e tij ndjenin si faj atdhedashurinë, por pse donin se Ai, njeri me rrebe mund të merrte qëndrime tepër të shtyme për një gjerak kishtar. Në atë kohë parime më të shtrënguara drejtonin Kishën Katolike. (Pllumi, Z. 2009; 132)

Fishta të gjithë veprimtarinë e tij jetësore e mbështet fuqishëm dhe bindshëm në dy shtylla sa etike aq edhe etnike, sa fetare aq edhe atdhetare: **Atmé** dhe **Fé**, të cilat shërbejnë si binarët nga ku ngrihet ideologjia e besimit të tij kombëtar. Edhe Thiese, duke folur krijimin e identiteteve kombëtare, burimin e kësaj ideologjie, e sheh pikërisht tek shtresa më e ulët e shoqërisë, ajo më e largëta, për të mos thënë, më e harruara.

Sipas saj, zakonet fshatare, fillimisht të gjykuara të denja për të ngjallur interes thjesht si gjurmë të kulturës stërgjyshore, bëhen gjithashtu simbol i atdheut me referentë etikë. Fshatarësia shërben tashmë për të dëshmuar që pavarësisht nga të gjithë ndryshimet e vërejtshme, kombi mbetet i pandryshuar. (Thiese, A. M. 2004;199)

Kur themi se Fishta mund të quhet iner / inter - preti i fuqishëm i shpirtit shqiptar, duhet të kuptohemi e të sqarojmë një moment të tillë. Ai nuk analizon fjetet më të ngjyrshme që përmbajnë pëlhurën e jetës shpirtërore të shqiptarit; nuk përdor mjetet e fuqishme që atij i jepte një kulturë shumë e gjerë për të shkatërruar lëmshin e ndjesive më të thella e nistore të popullit tonë. Nuk deshi t'ia hynte kësaj valleje, prandaj rrallëherë dha gjykime e nuk u përpoq ta ndreqte në artin e vet natyrën shqiptare.

I vuri vetes si qëllim paraqitjen e thjeshtë të botës autoktone, me bukuri e me shëmti të pamohueshme, me të mira e me të këqija, me virtyte e me të meta. Gjithashtu, u rrek të shuajë brenda shpirtit prirjet vetjake e kriteret e pjekura ndër studime të pareshtura. Edhe pse qëllimi i tij ishte kombëtar dhe atdhetar, sidoqoftë, e gjithë veprimtaria e tij atdhetare, politike, artistike kishin si pikë nisje dhe motivuese, veprimtarinë fetare dhe misionin e tij françeskan. Ai ishte një frat françeskan, e duke u nisur nga kjo nuk mund të lëmë mënjanë e të mos e vlerësojmë simbolikën e lëndës fetare edhe pse mund të thuhet se *vepra e tij letrare - artistike*, është e prirur drejt teorive joreligjioze.

⁹² Që fëmijë, u ndikua nga de Martino dhe nga misionari boshnjak Lovro Mihaçević, i cili ia ushqueu këtij djaloshi të zgjuar dashurinë për letërsi dhe për gjuhën amtare. Në seminarët dhe në institutet françeskane në Sutjeskë, në Livno dhe në Kreshevë ai studioi teologji, filozofi dhe gjuhë të huaja: latinisht, italisht, serbo-kroatisht. Ai u përgatit për karrierë ekleziastike dhe letrare. Autori më i njohur françeskan, shkroi lirikat: Mrizi i Zanavet, Vallja e Parrizit. Epin: Lahuta e Malcis, satirat: Anzat e Parnasit e Gomari i Babatasit, veprat dramaturgjike klasike si; Juda Makabre. E në fakt, ai dinte të krijonte sepse më s'pari përimitoi (analizoi) ndiesitë qi njohu më mirë. Ai madhonte (i) armët dhe naltonte (i) burrinë, nderën, besën e fjalën, tërvesën e kanunin doketar. Shka këndonte Fishta në gojën e fshatarit, ishte thalbi i psihes kombëtare. Këndej me arsye të plotë pohon Prof. E. Koliqi, ndër më të mëdhajt letrarë të kohës, në mos më i madhi. Gjergj Fishta, drejtoi jetën kulturore e letrare të Shkodrës, qendër e madhe kulturore shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX. Ishte drejtor i liceut **Ilyricum** dhe kryeredaktor i revistës, **Hylli i Dritës**. Me përçapjen e vet, Fishta ofron jo vetëm një shembull të aktit krijues të quajtur kritikë histori, letërsi – komparatistike, si anë të të njëjtit proces rikuperimi të vlerave domethënëse të letërsisë, por edhe një mësim mbi lirinë sovranë të shpirtit të, mbi aftësinë e tij për shkapërcimin e kufijve të të menduarit konvencional.

2. Shkolla letrare e françeskanëve

Formulimi “Shkolla letrare e françeskanëve” ka autor Ernest Koliqin. Ai, siç dihet, bëri tipologjinë e dy shkollave (rrymave) letrare shkodrane, geqe; ajo e jezuitëve dhe ajo e françeskanëve, duke mos marrë si bazë kriteri tematikën dhe stilin e krijimtarisë së tyre.

Tematika e trajtimit të përditshmërisë e mbi të gjithë përdorimi “me vend” i frazeologjisë së përditshme ishte edhe pika e parë e qartë dalluese mes dy shkollave letrare shkodrane.

At Zef Pllumi, (2009; 56) këtë “ndarje” e konsideron si ndarje zyrtare.

Me françeskâj, gjuha e popullit, në daç si frazeologji idiomatike në daç si ëndje typike trajtash shprehëse, merr zyrtarisht, të thomi, pagzimin e mellanit (mereqepit).

“Shkolla letrare e françeskanëve” është *idiomatike*, me tema të lidhura me një ambient me jetën e traditën e tij. Ndërsa “Shkolla letrare e jezuitëve” buron nga **literatura**, qoftë në planin e temave, qoftë në atë të stilit. Temat e autorëve françeskanë burojnë nga tradita dhe jeta e gjallë e shqiptarëve. Këtyre u shtohen temat nga historia e rendit françeskan dhe temat e sivëllezërve shqiptarë në shërbim të urdhrit. Gjithsesi, temat e françeskanëve i takojnë binomit Atmë e Fe.

Temat përputhen me diskutet (gjuhën burnore), ndaj temat ambientale të françeskanëve ndërthuren në diskurs idiomatik me shqipen e gjallë të Veriut (malësi e qytet), në gegnishte.

Sipas A. N. Berisha, (1977; 280) veprimtaria e shkrimtarëve françeskanë shtrihet në tri rrafshë kryesore:

- * **Përshpirtshme**, dashuria për hyjin dhe njeriun
- * **Kulturore**, njohja e saj kusht për zhvillim.
- * **Letrare**, që lidhet me zhvillimin e letërsisë.

Kulturalisht, dihet që shkolla e françeskanëve është e krishterë. Feja u dha shqiptarëve unitetin që u mungonte si shtet. Ajo ka shërbyer po ashtu edhe si lidhje me Perëndimin. (Plasari, A. 1991)

Në këtë tipologji, rrjedhimisht, **urdhri fetar** bëhet **përcaktues kulturor** i autorëve. Kjo nuk ndodh edhe me atë letrar, duke qenë se tema e stili, janë esenca letrare.

Shumë nga studiuesit dhe hulumtuesit e Shkollën Françeskane (*jo vetëm letrare*)⁹³ gjejnë pikëtakime me letërsinë e vjetër shqipe me karakter biblik. Por, edhe pse orientimi i françeskanëve kishte karakter kishtar e fetar, tharmi i kthesës së tyre është qartësisht i identifikueshëm dhe i dukshëm. Ata zbuluan psikologjinë dhe mendësinë e shqiptarit, ashpërsinë e ndjeshmërinë e tij, moralin, burrin e besës e hokatarin, gjaknxehsin e të drejtin.

Gërshetimin e dy venave të rëndësishme (atme dhe fe) të gjithë autorët françeskanë, (*qoftë Fishta, qoftë Harapi apo edhe si të tjerë si Prennushi, Palaj, Kurti, Rrota, Shantoja etj.*) nuk e panë si të veçuar nga njëri – tjetri apo si dy periudha të ndryshme, përkundrazi, i trajtuan si vazhdim i njëra – tjetrës, si plotësuese e deri diku si përmbyllëse.

Kjo nuk do të thotë se krijimtaria e shkollës françeskane nuk pati risitë e saj qoftë në formë a qoftë në përmbajtje. Kjo shkollë erdhi në një periudhë tjetër historike të popullit shqiptar, me forca të reja intelektuale, forca të cilat dinin ç’po bënin, pse po e bënin e mbi të gjitha si ta bënin.

⁹³ Jo vetëm letrare, sepse si e tillë Shkolla e Françeskanëve, lëvronte në stilin e saj artin, kulturën, shkencën, muzikën, historinë, përkthimin, që edhe pse të rrethqarkuara nga letërsia, munden shumë mirë të trajtohen edhe si zhanre e kontribute më vete.

Shkolla letrare e dalë prej Urdhrit Françeskan, mori formën e saj si një model arsimor dhe kulturor bazuar në pedagogjinë e urdhrit duke përhapur shkollimin në gjuhën shqipe dhe për më tepër, ajo ishte e lidhur me disiplinat e tjera albanologjike si shkencat historike etnografinë, arkeologjinë, antropologjinë kulturore, historinë, historinë e arteve dhe arkivistikën, shkencat filologjike, sepse

- a. botoi fjalorë, gramatika dhe studime mbi gjuhën,
- b. studioi folkloristikën, duke hulumtuar në trashëgiminë kulturore etnike shqiptare, duke mbledhur, studiuar dhe botuar trashëgiminë gojore,
- c. kultivoi sidomos letërsinë, teatrin dhe dramaturgjinë,
- d. dha ndihmesë në përkthim duke përkthyer në shqip kryevepra të letërsisë botërore,
- e. i dha elementët më të rëndësishëm publicistikës, jo vetëm duke nxjerrë periodikë të rëndësishëm si *Hylli i Dritës* dhe *Zani i Shna Ndout*, por duke dhënë një kontribut real, themelor në modelimin shkrimor publicistik në shtypin shqiptar,
- f. u dallua në kritikën dhe studimet letrare të kohës.

Duke iu referuar kombësisë së etërve françeskanë, mund të themi se ata ishim më autoktonë, në kuptimin e prejardhjes së tyre, por nga ana tjetër, duhet të theksohet fakti se ata ishin përcjellës të mirë edhe të kulturës perëndimore përveçse përçues të ungjillit e të krishterimit.

Sipas studiueses Klara Kodra (2000; 222), shkrimtarët e shkollës françeskane u dalluan edhe për hapjen ndaj kulturës latine, sidomos asaj italiane, por edhe asaj ballkanike (*kroate, boshnjake e malazeze*).

Nga ana tjetër, Mark Marku (2008; 59) shprehet se qysh në fillim françeskanët shfaqnin tre karakteristika që i bënin ata të dallueshëm nga grupet e tjera kulturore;

- a) së pari ata shfaqen si një elitë kulturore vendase në ndryshim nga grupet e tjera që janë grupe të diasporës.
- b) Së dyti ata janë një elitë kulturore e strukturuar dhe koherente në ndryshim nga grupet e tjera që nuk janë të tilla, dhe
- c) së treti ato shfaqen si një grup kulturor dhe fetar në ndryshim nga grupet e tjera që e zhvillojnë veprimtarinë kulturore jashtë patronazhit të fesë dhe nganjëherë edhe në konflikt me të.

Shkolla letrare e françeskane për Kujtim Shalën (Biblioetra, Viti 5, Nr.3) në njëfarë mënyrë është, shkolla tradicionale autentike shqipe, dhe për më tepër, - gjithmonë sipas studiuesit, - ajo pati një impakt të rëndësishëm në kulturën shqiptare dhe veçmas me letërsinë e saj, ngaqë për dallim nga shkolla letrare e jezuitëve, e cila më së shumti u mbështet tek literatura, ajo e françeskanëve pati një recepsion të pazakontë në publik për faktin se temat, stili, lidhja me letërsinë e kulturën gojore dhe me jetën e gjallë e bëjnë shkollën letrare të françeskanëve, disi më popullore.

Shkolla letrare françeskane e Shkodrës konsiderohet tradicionale, sepse u mbështet në arritjet më të mira të letërsisë së vjetër shqipe (*letërsinë e Budit, Buzukut, Bogdanit, Bardhit etj., të cilët, sidoqoftë, shkruan letërsi edhe fetare*), duke ruajtur tematikën, personazhet e kultit e të adhurimit fetar, ngjarje, psikologji e mendësi e mbi të gjitha idiomatikë dhe simbolikë, por që sidoqoftë nën ndikimin e elementit të ardhur nga jashtë, domethënë nga edukimi i shkrimtarëve, nga formimi i tyre intelektual e akademik, nga prejardhja e tyre (*Rasti i De Martinos!*) latohej, finohej e bëhej më modern.

I këtij mendimi është edhe Elsie (1997; 302), albanologu skocez. Ai shprehet se shkolla letrare katolike e letrave, hyri në epokën e vet të artë në dekadat e para të shekullit të njëzet dhe për këtë lulëzim të kulturës gege, atij i takon një meritë e madhe.

Për At Z. Pllumin, kuvendi Françeskan u ba pothuaj qendra ma aktive e nacionalizmit shqip rreth të cilit u bashkuen mjaft patriotë të asaj kohe, dikush përreth Fishtës për letrat e artet e kush tjetër për doke, kanun e folklor rreth Shtjefën Gjeçovit. Shkolla e Françeskâjvet i a hapi dyet letersis s'onë vasatin shrehes populluar, i fali tharmin e krenis shqiptare, gjuhën e ndjesive burrnore e fisnike të maleve. Landën letrare e nxorri nga jeta e Shqipnis, sidomos nga ajo e popullit mâ të thjeshtë e mâ pak të prekun nga influkset e hueja. (Pllumbi, Z. 2001; 6)

Kështu, kritikata dhe studimet e kohëve të fundit, indirekt janë shprehur pro mendimit të dytë edhe dijetarët vendas duke çmuar se françeskanët nuk qenë vetëm mbledhës dhe studiues të rapsodive, por, në një farë mënyre, edhe bashkëautorë të tyre, pak a shumë me të njëjtin rol që patën murgjit grekë në dëshmimin e këngëve akritike. Ky është konstatim i studiuesit Sh. Sinani (2011;15), i cili në studimin monografik rreth mitologjisë në eposin e kreshnikëve, shprehet se françeskanët *e shihnin të nevojshme* t'i jepnin shpjegime lexuesit mbi "argumentin" e rapsodive, duke e përligjur atë edhe me shënime shkencore.

Shkrimtarët e këtij Qarku – ashtu siç i përcakton N. Resuli (1966; 262) - nuk menduan vetëm si barinj të shpirtave duke kryer rregullisht detyrat e zakonshme klerikale ndaj besimtarëve, por ata me njohuritë e tyre gjuhësore, historike, shkencore, filozofike dhe doktrinale, u bënë protagonistë të luftës midis katolicizmit, që po tkurrej dhe islamizmit që po përhapej. Ai i vlerëson kaq shumë shkrimtarët katolikë, kontributin dhe kthesën e rëndësishme në kulturën shqiptare, saqë pyet në mënyrë retorike: *Çfarë do të kishte bërë vaki me Shqipërinë sikur të mos kishin qenë katolikët?*

Shkolla letrare françeskane e Shkodrës, duke iu referuar etiketimit që përdor studiuesi Namik Resuli, u rendit si e tillë si "nomenklaturë", Qarku Katolik i Shqipërisë Veriore.

Françeskanët krahas institucioneve të ushtrimit të aktivitetit, propagandimit të kredos së tyre, publikimit të ideve dhe aspiratave, shkollat si të tilla përdoren për herë të parë në harkun kohor 1940 – 1943, në një kuptim terminologjik të argumentuar. Këtë argumentim e ka dhënë Ernest Koliqi, duke bërë që kjo të jetë përpjekja e parë dhe e fundit për një konceptim të tillë terminologjik.

Dy shkollat letrare shkodrane, janë botuar në *Albania e Vogël* dhe *Shëjzat*, me fragmente nga viti 1954 në 1973. (Albania e Vogël 9-12)

Sipas Koliqit, "Shkolla e Françeskâjvet, mbas msimit t'At Leonard De Martinit, shembuj për t'u ndjekun filloi t'i kërkonte e t'i gjente në popull dhe këshillonte me shtí në përdorim frazelogjin". Ai vazhdon më tej duke shtuar se "*Shkolla e Françeskâjvet i hapi dyert e letersis s'onë visarit shprehës populluer, i fali tharmin e krenis shqiptare, gjuhën e ndjesive burrnore e fisnike të maleve. Landën letrare e nxorri nga jeta e mbarë Shqipnis, sidomos nga ajo e popullit, në daç si frazeologji idiomatike në daç si éndje typike trajtash shprehese, merr zyrtarisht, të thomi, pagzimin e mellanit (merekëpit)*". Duke prekur edhe dallimet mes dy shkollave, asaj të jezuitëve dhe asaj të Françeskâjvet – siç shprehet ai – është i kujdesshëm duke sugjeruar se ndryshimi ndërmjet dy shkollave dhe veprimtaria e sejcilës zhvillue dâmas, duhet të kuptohet në mënyrë të urtë, sepse në fund të fundit dallimi në mes të tyre është relativ dhe lidhni latente për osmozi janë të paprême.

Duke ndjekur lëndën e gjykimit të Koliqit (1998; 32-35), nuk besojmë se emërtimi shkolla letrare françeskane e Shkodrës, synonte prerjen horizontale, duke kushtëzuar llojin e krijimtarisë së një shkolle apo të një tjetre (*Shkolla jezuite nga ana tjetër!*), ashtu si në një farë mënyre, ka sugjeruar apo diskutuar kritika letrare e asaj kohe, por synon gjetjen e burimit apo burimeve nga ku rrodhi ai lumë studimesh, librash, organesh publikues sa në sasi ashtu edhe në cilësi, duke u bërë kthesë e rëndësishme dhe referuese për të gjithë kulturën shqiptare, jo vetëm të gjysmës së parë të shekullit XX, por edhe për të gjithë rrafshin diakronik kulturor shqiptar.

3. Françeskanët si promotorë të fillesave të etnologjisë dhe etnografisë shqiptare

Françeskanët mbërritën në vendin tonë pas benedikëve dhe domenikëve. Sipas të dhënave, mendohet se françeskanët, për herë të parë, në Shqipëri vijnë që në fillim të Urdhrit të tyre, përkatësisht që në kohën e vetë Shën Françesku dhe misionin e tyre të parë ta ketë themeluar vetë Shën Françesku në vitin 1219, i cili u kthye nga Egjipti dhe Siria erdhi e u ndal në Lezhë. (Mirdita, Z. 1998; 261)

Françeskanët shkruan shqipen, përdorën idiomën, siç buronte nga goja e njerëzve, por edhe e sprovuan më tej atë, sidomos në vëllimet me poezi. E kjo falë punës në terren, këmbënguljes së tyre etike, shkencore, humane e intelektuale. Shqiptari i thjeshtë gjente elementet e gjuhës së përditshme dhe të vetë përditshmërisë, sepse ata shkruan sipas modeleve popullore e në modelet popullore duke përdorur kryesisht gjuhën e përditshme.

Studiuesi Kristaq Jorgo (Seminari i Prishtinës, 1996), në një punim mbi figurën e Fishtës, dhe të françeskanëve të tjerë shprehet: *“Për herë të parë tani, në këtë qark, letërsia shqiptare mund njëherësh të krijohet, botohet, shpërndahet, receptohet e kritikohet, ndryshe nga më parë, brenda hapësirës etnike shqiptare. Mund të cilësohet ky modelim institucional i sistemit letrar kombëtar. Në realizimin e kësaj detyre Fishta jep si krijues, kritik, organizator i jetës letrare etj., një kontribut i dorës së parë.*

Jo vetëm studiuesi Jorgo transmeton këtë konsideratë për Fishtën. Duke shërbyer si induksion i urdhrit ku aderonte, Fishta është cilësuar si figura më e madhe dhe më e fuqishme e letërsisë shqiptare (shqipe) të gjysmës së parë të shekullit XX. Studiuesit si Eqrem Çabej, Benedikt Dema, Françesko Ercole, Maksimilian Lamerci, Zef Skiroi, Ernest Koliqi, Georg Shtadmyleri, Zef V. Nekaj, Xhuzepe Gradilone, Ignjac Zamputi, Tonin Çobani, Aurel Plasari etj., ndajnë të njëjtin mendim.

Veprimtaria dhe ndërmarrja e tyre kulturore buronte shërbimin e tyre, shërbim i rrënjëzuar në Shqipëri që në lindje të kristianizmit. Giuseppe Gelcish (2012; 57) e pohon këtë kur thotë se: Veprimi i katolikëve në Shqipëri kje i vijueshëm qysh prej fillimit të kristjanizmit e deri ndër dit' tona; por, prejse me pushtimin otoman fati i vendit tonë kje në mndyre te jashtëzakonshme i kobshëm mbasi na dau nderrmjet vedit, na dha rrugat e mërgimit, na dërmoi e na çfaroi gati krejt, kshtu edhe veprimi i elementit katolik për kah kultura mund te dahet dysh:

- Veprimi i katolikëve sa komi qindroi në besimin e krishterë, e
- Veprimi i katolikëve gjatë pesë shekujsh robnimit, errisijet e ligshtijet.

Nëse do ta studionim këtë dukuri përqendrimi me mjetet e shkollës difuzioniste, do të shpreheshim se distancat gjeografike, sado e madhe që të jetë, është pa rëndësi reale për përhapjen e kulturave, dukuri që është gjithmonë e mundshme. Ata pranojnë që njeriu është qenie shumë elokuyente dhe zbulimet që ai (njeriu) kryen përhapen shumë më shpejt sesa ato përsëriten, kur elemente të ndryshme të një kostelacioni kulturor të dhënë të jenë bashkëvepruese dhe udhëtojnë së bashku, ku në njërin prej këtyre elementeve, në disa raste, identifikohen pjesë të tëra dhe, nëse lëvizën pika të veçanta të gravitetit etnokulturor, për rrjedhim ndodh zhvendosja e të gjithë kompleksit kulturor. (Jakllari, A. 2003; 58) Duke cituar Jakllarin, mund të thuhet se ka shumë të dhëna që provojnë se cikli verior nuk është aq verior, sa të mbetet i vetëveçar. Motive themelore të tij gjenden të zhvilluara në folklorin e viseve jugore në formën e rrëfimeve përrallave apo legjendave.

Por, sidoqoftë, Urdhri françeskan në viset shqiptare, nuk pati mundësinë ta ushtrojë lirshëm veprimtarinë e tij baritore dhe kulturore, për shkak të pushtimit të gjatë osman, i cili shumë herë ia vuri në dyshim deri edhe ekzistencën fizike, por gjithsesi zhvillimet kulturore shqiptare përgjatë mesjetës dhe deri në gjysmën e parë të shekullit XX, janë të lidhura e të ndërthurura me jetën dhe me veprimtarinë kishtarë vendase, sepse kisha kishte monopolin e dijes, çka dëshmon njëherazi karakterin historik të intelektualit klerik katolik, e ku një vend me mjaft rëndësi zë veprimtaria misionare e françeskanëve, e cila domosdo u ndërtua dhe u zhvillua mbi themelet e kulturës së krishterë.

Vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kur Kuvendi Françeskan i Shkodrës merr një rol urban, sikurse e meritonte ai qytet, veprimtaria e këtij urdhri (bashkë me atë të Urdhrit të jezuitëve), krijon formacionet kulturore përkatëse bazë të formimit socio-kulturor e letrar të një prej periudhave më të qenësishme letrare të letërsisë shqipe.

Sipërmarrja e vetëdijshme apostolike, atdhetare dhe kulturore ishte dëshmia më thelbësore e karizmës françeskane, prej së cilës u kultivua kultura françeskane si përgjegjësi pastorale dhe mbi të gjitha si vetëdije kulturore dhe universale njëherësh në mjedisin shqiptar të prapambetur nga pikëpamje kulturore. Françeskani shqiptar pati rolin dyfish të kishtarit e të laikut, në kuptimin se ai ishte edhe mësues i kishës dhe praktikave të saj, por edhe mësues i gjuhës shqipe, nga ku rrjedh edhe laiciteti i punës së tyre.

4. Përfundime

Etërit françeskane, si promotorë të mendimit dhe veprimtarisë etnologjike dhe etnografike, u vendosen në territorin shqiptar, duke u shndërruar në njohës të thellë të mendësisë e shpirtit të popullit mes të cilit jetuan. Ata mbetën krijues të një elite dijetarësh e personalitetesh të larta kulture, arti e shkence. Etërit françeskanë shqiptarë i qëndruan besnikë besimit dhe vizionit të tyre. Besimi dhe vetëdija e tyre edhe sot e kësaj dite na mëson se aktiviteti i tyre i ngjeshur e tyre kulturor dhe shpirtëror lidhej drejtpërsëdrejti me riformulimin e një identiteti kombëtar, që mishëronte pikat më të forta e më të rëndësishme të traditës kombëtare, vlerat më të qenësishme të një shoqërie të emancipuar e që bashkëjeton mbi këto vlera. Ideali i tyre i mbështetur në Atme dhe Fe, u shtri e u zgjerua në evidentimin dhe thellimin e kulturës kombëtare, që cila, sipas mendimit tonë, mbetet veprimtaria më me vlerë e të gjithë aktivitetit kulturor, artistik, patriotik dhe mendimtar të Urdhrit Françeskan në Shqipëri

Rravigimi i këtij *Urdhri* shkruar me shkronja të arta kalon nëpër këto lugje:

- themelimin i Kolegjit Françeskan më 1861,
- futjen e gjuhës shqipes si gjuhë mësimi më 1903 (kohë kur Fishta bëhet drejtor!),
- themelimin i revistës *Hylli i dritës* 1913,
- themelimin shtypshkronjës françeskane më 1916,
- hapjen e i Liceut *Illyricum* më 1921,
- hapjen e arkivës, bibliotekës, grupeve teatrore e ato muzikore, botimin i veprave letrare origjinale etj.,

gurë kilometrikë, shenjë – tregues dhe udhërrëfyes të mënyrës sesi mund të gatuhet brumi i një kulture të rrallë si ajo shqiptare, sesi mund të shkruhen vargje e poezi me një gjuhë me tingëllim zanash e hyjnish, si mund të këndohen vajet, brengat në dy tela që përqoken, përqafohen e ngërthehen, se si zbulohet dëshira për ta shkruar historinë objektivisht si vëzhgues me pjesëmarrje, sesi zhvillohet shqisa e kërkimit arkeologjik, etnologjik dhe antropologjik, por mbi të gjitha për ta na mësuar sesi dhe sa duhet atdheu!

Kështu At Shtjefën Gjeçovi (1874–1929), prift françeskan shqiptar, në fillim të shekullit të njëzetë mblodhi traditat dhe legjendat nder banorë të Veriut të Shqipërisë. Botimi i tyre, së pari, daton në vitin 1913 e më pas në revistën françeskane *Hylli i dritës* në Shkodrë. Shtjefën Gjeçovi (1933,1993) la trashëgim një vepër të rëndësishme në të cilën ai regjistroi dhe përshkroi me përpikëri shkencore institucionet sociale zakonore

At Leonardo de Martino, mësuesi i parë i Gjergj Fishtës, arbëreshi që i këndoi me nota romantike dashurisë për Shqipërinë (L'arpa d'un italo-albanese, Venedik, 1881) dhe i pari që vë në skenë dramën shqipe.

Dinjiteti kishtar i Monsinjor Vinçenc Prennushi, sipas A. Pipës, i kombinuem me vlerën e tij letrare dhe i kqyrun nën prizmën e patriotizmës shqiptare i jep fytyrës së tij një randësi madhore në radhët e përfaqësuesve të kombit. Poeti i âmëlcis, do e quante Fishta, por edhe poeti i kohës së vet që shkroi aq bukur për figurën e nënës:

Nana

*Sa m'knaqë perherë mue nana:
Virtytesh një pasqyrë,
Nuk ka nevojë me m'folun,
Kam mjaft kur ajo më kqyrë.*

At Gjergj Fishta, Homeri shqiptar, njohësi më i thellë i psikikës dhe mendësisë shqiptare, virtuoz i vargut dhe i përdorimit me mjeshtëri të dialektit geg! Enciklopedi e gjallë i cili e zgjeshi dhe e la vijë brumin e gjuhës dhe kulturës shqipe, duke na lënë vepra të një cilësie e prodhimtarie, që mund të krahasohen me Shekspirin. Pasionat dhe i dashuruar thellësisht me rrënjët e tokës së vet, krenar për gjakun që i rrjedh nder deje (Edhe pse kritikohet për vargjet: *Le ta dije gjithë bota mbar'/se Fishta nuk osht shqiptar!*).

At Anton Harapi, studiues me shokë të rrallë, sociolog dhe psikologjik i hershëm dhe interpretues elegant i të drejtave të njeriut, sidomos e grave dhe fëmijëve, gjë të cilën e dëshmojnë veprat më të njohura të tij: *Edukata ose mirërritja e fëmijëve* (1925), *Vlera shpirtërore* (1936), *Andrra e Pretashit* (1933 – 1940). Edhe pse kjo vepër është konsideruar psikologjike, në fakt, sipas autorit qëllimi i saj ka qenë thjesht kombëtar: fiset e Hotit dhe të Grudës, t'mbetura jashtë kufirit politik të sotëm, janë thjesht shqiptare. Bashkimin kombëtar, përdorimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, ruajtjen e zakoneve, traditave dhe lëngut etnik shqiptar, Harapi e la trashëgim dhe amanet kulturor!

At Bernardin Palaj dhe At Donat Kurti, themeluesit e laboratorit antropologjik shqiptar. Nëse në ditët e sotme ne i gëzohemi faktit që jemi përdorues të eposit më të vjetër dhe të të vetmit i gjallë në Ballkan, siç është *Eposi i Kreshnikëve*, duhet t'i falemë At Bernardin Palajt dhe At Donat Kurtit. *Visaret e Kombit dhe Prrallat Kombëtare: mbledhë prej gojës së popullit*, ruajnë akoma gjurmët e tyre që shkelin e rrëshqasin në malet e veriut të Shqipërisë, gjurmë përkushtimi, profesionalizmi të rrallë, dashurie dhe pasioni të papërsëritshëm.

At Marin Sirdani, historiani dhe filozofi teolog, që gjurmues i rrallë i toponimeve dhe legjendave shqiptare, autor i *Skanderbegu mbas gojëdhënash*, *Për historinë kombëtare*, *Shqypnia e shqiptarëve*, pjesa më e madhe e së cilës nuk e pa dritën e botimit.

Por edhe gjuhëtarët e njohësit e hollë të shqipes si Benedikt Dema e Justin Rrota, filozofi Gjon Shllaku, muzikant i mjeshtëror, Leon Kabashi e shumë e shumë të tjera emra të cilët i dhanë aq shumë kulturës dhe trashëgimisë kulturore shqiptare, vepra e të cilëve akoma në ditët e sotme mbetet e hapur për studime më të thelluara e më të mirëfillta.

Referenca

- [1]. Albania e Vogël (Albanie Libre) (1954 – 1961), Shëjzat, Vjeti XVII\1973. Nr.9-12, Shtatuer-Dhetuer, 1973.
- [2]. At Zef Pllumi, Françeskanët e Mëdhenj, Tiranë, 2001, Ilar, fq. 6.
- [3]. Berisha, Anton, Nikë. Atë Anton Harapi, Njësimi kombëtar dhe ideali kombëtar, Kuvendi Françeskan i Gjakovës, 1977, fq. 280.
- [4]. Berisha, Anton, Nikë. Njëmendësia e Fjalëve, (Mundësi interpretimesh letrare) Shpresa & Faik Konica, Prishtinë, 2006, fq.9.
- [5]. Elsie, Robert. Histori e Letersise Shqiptare, Dukagjini, Pejë, 1997, fq. 302.
- [6]. Fishta, Gjergj. Estetikë dhe etikë, Antologji përgatitur nga Persida Asllani, Hylli i Dritës & Shtëpia e Librit,1993.
- [7]. Fjalime nga Fishta, Harapi, Koliqi, Redaktoi dhe pajisi me shënime Tonin Shiroka, Shtëpia Botuese Uegen, Tiranë, 2009, fq.7.
- [8]. Gelcich, Giuseppe. Studi storici documentati, versioni italisht, Ulan Press, 2012.
- [9]. Jakllari, Adem. Histori e mendimit etnologjik dhe mitologjik, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2003, fq. 58.
- [10]. Jorgo, Kristaq. “Fenomeni Fishta në historinë e letërsisë shqiptare”, në Seminarin XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Tiranë 19 – 31 gusht 1996. Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Botimet Toena, Tiranë, 1996.
- [11]. Kodra, Klara. Studia Albanica, Accademie Des Sciences d’ Albanie, Section des Sciences Sociales, XXXIII Année, Tiranë, 2000.
- [12]. Koliqi, Ernest. Dy shkollat Letrare shkodrane, Boton Kisha e Shën Ndout, Prishtinë, 1998, fq. 32 – 35.
- [13]. Marku, Mark. Dituria kulturore françeskane, në Studime albanologjike, Viti XIII\2008.
- [14]. Mirdita, Zef. Krishtërimi ndër shqiptarë, Drita & Misioni Katolik Shqiptar në Zagreb, Prizren – Zagreb, 1998, 261.KKoli
- [15]. Plasari, Aurel. Gjergj Fishta dhe historia e letërsisë. Rilindja Demokratike, nr. 2, Tiranë, 1991.
- [16]. Pllumi, Zef. At. Saga e fëmijnisë: un që jetova shumë shekuj: tregim autobiografik, Pajisi me shënime Ledi Shkreli (Shamku) Botimet Françeskane, Shkodër, 2009, fq. 132.
- [17]. Resuli, Namik. Tribut Gjergj Fishtës, poetit shqiptar, në Jeta e Re, Prishtinë, Nr. 3, Maj – Qershor 1966.
- [18]. Sinani. Shaban, Mitologji në Eposin e Kreshnikëve, Studim Monografik (Botimi i Tretë) Naimi, Tiranë, 2011, fq. 33.
- [19]. Shala, Kujtim. Shkolla letrare e françeskane, në Biblioetra, Revistë e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Viti 5, Nr. 3.
- [20]. Shehri. Dhurata, Koliqi mes malit dhe detit, Onufri, Tiranë, 2006, fq. 23.
- [21]. Thierse, Anne Marie. Krijimi i identiteteve kombëtare. Evropa e shekujve XVIII – XX. Përktheu nga frëngjishtja Etleva Shiroka, Dukagjini, Pejë, 2004.